



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT

N J O F T I M

PËR PROVIMIN E DIGJITALIZUAR PËR PUNËSIMIN SI TEKNIK I SHKENCAVE
MJEKËSORE

Ju bëjmë me dije se duke nisur nga fillimi i muajit Mars 2020, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (më poshtë QSHA), me adresë: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr. 23, Tiranë (ish-ATSH), do të zhvillohet provimi i digjitalizuar për punësimin si teknik i shkencave mjekësore.

Në vijim do të publikohet kalendari me profilet, datat dhe oraret përkatëse për zhvillimin e provimit.

Kandidati duhet të paraqitet pranë QSHA-së **30 minuta para fillimit** provimit dhe duhet të jetë i pajisur me:

1. Letërnjoftim (Kartë ID ose Pasaportë, dokumenti origjinal);
2. Kopje të Kartës ID ose Pasaportës;
3. Faturën e pagesës (me vulën e bankës përkatëse) së tarifës për QSHA-në.

Kandidatëve të cilëve u mungojnë këto dokumente, nuk do të mund të marrin pjesë në provim.

Për paraqitjen në mjediset e provimit, kandidati duhet të ketë parasysh rregullat e mëposhtme:

1. ndalohet **marrja me vete** dhe **përdorimi i celularëve** dhe mjeteve të tjera të komunikimit, pasi ky vlerësohet si kriter skualifikimi;
2. ndalohet komunikimi gjatë zhvillimit të provimit;
3. ndalohet duhani dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e provimit;

Për të gjithë kandidatët, lutemi të verifikoni identitetin, profilin, si dhe orarin e provimit në faqen zyrtare të QSHA-së në adresën www.qsha.gov.al, faqja e parë “Provimet e Shtetit”, rubrika “Njoftime”, lista e kandidatëve për provimin e digjitalizuar për punësimin si teknik i shkencave mjekësore.